

Titulli i projektit:

Praktika profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit – krijimi i një ure bashkëpunimi mes aktorëve të përfshirë në këtë proces



Personel akademik i projektit:

Prof. Dr. Elida Tabaku - Udhëheqëse e projektit

Prof. Dr. Viktor Ristani - Bashkëpunëtor i projektit

Dr. Daniela Hasa - Bashkëpunëtore e projektit

Dr. Leonora Lumezi - Bashkëpunëtore e projektit

Dr. Etleva Kondi - Bashkëpunëtore e projektit

Dr. Hatixhe Leka (Sejdini) - Bashkëpunëtore e projektit

Msc. Brunilda Kondi - Bashkëpunëtore e projektit

Msc. Blerina Zaimi - Bashkëpunëtore e projektit

Përmbledhja e Projektit:

Projekti i propozuar nga pedagogët e Departamentit të Gjuhës Angleze synon të thellojë analizën e nevojave të studentëve të mësuesisë në prag të praktikës profesionale dhe të krijojë një platformë bashkëpunimi dhe bashkëbisedimi mes aktorëve kryesorë që marrin pjesë në këtë proces mjaft të rëndësishëm për mësuesit praktikantë. Një platformë e tillë do t'i ndihmojë ata të shprehin idetë e të japin ndihmesën e tyre në lidhje me mbarëvajtjen e praktikës profesionale e do të lehtësojë ndjeshëm transferimin e dijeve nga shkolla në jetë.

Referuar Nenit 9 të Rregullores për Organizimin dhe Zhvillimin e Praktikave Profesionale për Profesionin e Rregulluar të Mësuesit, Institucionet e Arsimit të Lartë që ofrojnë programe studimi në mësuesi a) bashkëpunojnë me ASCAP-in për të hartuar programe orientuese për praktikën profesionale dhe b) këtë program ua ofrojnë studentëve që diplomohen në programin e mësuesisë. Duke marrë shkas nga ky rregullim ligjor i cili parashikon përfshirjen e Institucioneve të Arsimit të Lartë si edhe nisur nga nevojat e kandidatëve që do të aplikojnë për licensën e mësuesit, propozohet zhvillimi i këtij projekti si një hap i parë që hidhet për t'u pasuar nga një program afatgjatë mbi zhvillimin e vazhdueshëm profesional.



Ky projekt është në kuadër të zgjerimit të bashkëpunimit të universitetit me institucione publike dhe private me qëllim lehtësimin e transferimit të dijeve, përshtatjen me nevojat e tregut të punës dhe rritjen e ndikimit të UT-së në shoqëri. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, përkatësisht Departamenti i Gjuhës Angleze ndërmori një studim bazë dhe një analizë të vlerësimit të nevojave, në formën e një trajnimi që u organizua më 29-30 qershor 2021, online. Të dhënat e këtij studimi dhe analiza e vlerësimit të nevojave evidentuan disa nga problemet dhe vështirësitë që praktikantët hasin gjatë procesit të aplikimit për praktikën profesionale, gjatë zhvillimit të saj si edhe në përfundim të procesit që lidhet me dorëzimin e dokumentacionit dhe vlerësimin nga komisioni i ngritur për këtë qëllim.

Projekti i propozuar është i një natyre të tillë që ngërthen disa elementë, si: ndërgjegjësimin e praktikantëve për rëndësinë e informimit para fillimit të procesit, rëndësinë dhe njohjen më të mirë të legjislacionit, rregulloreve dhe procedurave nga ana e praktikantëve si edhe krijimin e një platforme bashkëpunimi ndërmjet fakultetit, praktikantëve, mësuesve të gjuhës angleze dhe institucioneve përkatëse të arsimit parauniversitar, e cila do të shërbejë si një urë lidhëse mes tyre për të adresuar me sukses problemet e evidentuara dhe sfidat që shoqërojnë procesin.

